



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:235430
Datë: 14.12.2023
Numri i dokumentit: 05063540

C-IV-13-0232

Ankuesi

Q H, fshati M, Suharekë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 11 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. APROVOHET** ankesa si e bazuar dhe **ndryshohet** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN017-0216 datë 05 mars 2013.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankuesit **Q H** në emër të kërkesës për dëmshpërblimin lidhur me ndërprerjen e parakohshme të kontratës së punës, t’i paguaj **shumën prej 1,350.00 €**.
- 3.** Shuma e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 15 mars 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN017-0216 datë 05 mars 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për dëmshpërblimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,350.00 € nga NSH “NIN Ramiz Sadiku” (në likuidim). Ankuesi pohoi se ka aplikuar tek e paditura me kërkesë për dëmshpërblim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe se e paditura duke vendosur sipas vendimit ka refuzuar kërkesën për dëmshpërblim pa asnjë bazë ligjore, duke aluduar se kërkesa është e pasafatshme, pastaj lëshohet në shqyrtim dhe refuzon kërkesën me pretekst se kërkesa nuk reflekton mundësinë e dëmshpërblimit, e ky konstatim është në kundërshtim me dispozitat ligjore (Ligji nr. 04/L-034) neni 40.1.6.2 ngase kjo dispozitë përcakton të drejtën që ka secili punëtor në realizimin e dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes

së marrëdhënies së punës, kur ndërmarrja është në likuidim. Ankuesi më tej theksoi se ka punuar tek e paditura deri më datë 22 prill 2006, kur ndërmarrja është vendosur në procedurë të likuidimit. Vendimi bazohet në faktin se ankuesi nuk ka realizuar të ardhura personale 12 muajt para likuidimit, kjo paraqet edhe një provë që punëtori përveç dëmshpërblimit i takon edhe pagesa në kompensimin e të ardhurave personale për 12 muajt. Ankuesi i propozon gjykatës që nga të gjitha këto të dhëna të sipërshënuara, nga provat e propozuara, vendimi i të paditurës duhet të anulohet për shkak se është në kundërshtim me ligjin ashtu që gjykata të administroj provat e propozuara dhe të aprovoj si të bazuar kërkesën e ankuesit, ti anuloj dhe shpall nul vendimin e AKP-së dhe të obligohet e paditura që ti paguaj ankuesit shumën prej 1,350.00 € si dhe kompensimin e 12 pagave mujore sipas lartësisë që do ta jep eksperti financiar dhe të obligohet e paditura të paguaj të gjitha shpenzimet procedurale.

Ankuesi në mbështetje të ankesës së tij dorëzoi Vendimin e kundërshtuar dhe dëshmitë në kopje si: Librezën e tij të punës dhe letërnjoftimin.

Me 04 shtator 2013, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesin përmes së cilit kërkoi nga i njëjti që ndër të tjera të paguaj taksën gjyqësore. Me 19 shtator 2013, ankuesi ka paguar taksën gjyqësore.

Me 06 gusht 2014, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Neni 70.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 përcakton që ankesat e parashtruara në DHPGJS kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim Ligjin nr.04/L-034 për AKP – në. Së pari është me rëndësi të theksohet së kërkesa nuk u refuzua për shkak se ishte parashtruar pas afatit për parashtrim të kërkesave. Një gjetje e tillë është e qartë edhe nga vetë vendimi në par.2 të të cilit thuhet se kërkesa *“nuk u refuzua mbi baza pranueshmërie”*. E paditura në çdo rrethanë konfirmon se ankesa u parashtrua me datë 31 dhjetor 2010 që është pas afatit të fundit për parashtrim të kërkesave datë 23 korrik 2006. Neni 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/-034 u jep të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës vetëm atyre punëtorëve që janë pushuar si rrjedhojë apo një veprim të ndërmarrë nga AKP-ja dhe se nga leximi i këtij neni kuptohet se ka dy kushte ligjore që dikush të përfitoj nga dëmshpërblimi për ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës: (1) një pushim nga puna e punonjësit që (2) i cili duhet të ketë ardhur si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP-ja. Rrjedhimisht, ankuesi nuk përmbush kushtin nga Neni 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 dhe ai nuk gëzon të drejtën për të marrë kompensim të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. E paditura i përmbahet qëndrimit që marrëdhënia e punës u ndërpre në kohën kur ankuesi pushoi së punuari për NSH-në. E paditura thekson se librezja e punës e ankuesit ishte mbyllur me datë 22 prill 2006 që ai të ketë të drejtë të përfitoj nga shpërndarja e fondit të 20% nga shitja përmes procesit të privatizimit sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 dhe nuk ka asnjë ndikim ligjor mbi të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës. Është me rëndësi të theksohet se kriteret për përfitim nga shpërndarja e fondit të 20% -shit nga shitja përmes likuidimit të NSH-së (asetet) janë krejtësisht të ndryshme nga kriteret që vlejné për të kërkuar dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës, siç edhe u citua më lart dhe parashikohet Neni 40.1.6.2 i Shtojcës së

Ligjit nr.04/L-034. Sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (i plotësuar dhe ndryshuar), punëtorët kanë të drejtën për të përfituar nga shpërndarja e të ardhurave që dalin nga shitja përmes likuidimit të NSH-së nëse: (1) Ata ishin të regjistruar në NSH në kohën e privatizimit të NSH-së, (2) Kanë qenë në listë pagesat e NSH-së jo më pak se tre vjet. Për këtë arsye dita e fundit e punës e cila shfaqet në librezën e tij të punës nuk është relevante bazuar në arsyet e lartcekura. E paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe/ose të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me nenin 70.4 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033. E paditura në mbështetje të mbrojtjes së saj dorëzoi dëshmitë në kopje si: Kërkesa për emërim të përbërjes së Autoritetit të Likuidimit, datë 19 nëntor 2012, Regjistri i punëtorëve aktivë në marrëdhënie pune të NIN “Ramiz Sadiku”, Regjistri i punëtorëve pasivë në marrëdhënie pune të NIN “Ramiz Sadiku” që të dyja të datës 31 gusht 2005, Lista e punëtorëve të NSH-së datë 13 shkurt 2006 AKM (Agjencia Kosovare e Mirëbesimit), Akontacionet e rrogës për muajin janar 2005, shkurt 2005, mars 2005, prill 2005, qershor 2005, roga shtator 2005 (Drejtoria, drejtoria-rojet, seperacioni-rojet, fabrika e re – rojet), (Drejtoria, drejtoria- rojet, seperacioni-rojet, tulltorja e re- rojett, fabrika e re-rojet). Lista e pagave të NSH për muajt tetor (X), nëntor (XI) dhe dhjetor 2005, Lista e të ardhurave personale të papaguara të punëtorëve të NSH “Ramiz Sadiku” Prizren për muajt janar 2005 deri më 19 dhjetor 2005.

Për detaje tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa aprovohet si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i AL.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesi ka kundërshtuar vendimin e AL nr. PRN017-0216 datë 05 mars 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e tij për dëmshpërblimin e ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1,350.00 € nga NSH “NIN Ramiz Sadiku” (*në likuidim*). Në ankesën e tij kundër vendimit të kundërshtuar ankuesi e zgjeron ankesën e tij ashtu që tani kërkon edhe kompensimin e të ardhurave personale për 12 muaj, me propozim të sigurimit të ekspertizës financiare. Gjykata konsideron që një kërkesë e tillë është jashtë kufijve të shqyrtimit të ankesës kundër vendimit të kundërshtuar andaj si e tillë nuk do të merret në shqyrtim në këtë procedurë. Më këtë refuzohet edhe propozimi për sigurim të ekspertizës financiare për kompensimin e të ardhurave personale për 12 muaj.

Sipas nenit 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:*

- 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;
- 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;
- 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;
- 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetënëntë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore;
- 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH “NIN Ramiz Sadiku”. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë ankuesi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj. Ankuesi pretendon se ka qenë punëtor i NSH-së, deri sa ndërmarrja ka shkuar në privatizim me datë 21 shkurt 2006. E paditura e kundërshton kërkesën e ankuesit duke pretenduar se ankuesi nuk ishte në një marrëdhënie pune aktive me NSH-në, pasi emri i tij është i përfshirë në Regjistrin e punëtorëve pasivë të NSH NIN “Ramiz Sadiku” datë 31 gusht 2005 (Emri i ankuesit është në numrin rendor 60). E paditura nuk e ka kontestuar përvojën e punës së ankuesit dhe as lartësinë e pagesës së kërkuar.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në librezën e tij të punës si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezja e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte krijuar marrëdhënie pune me NSH “NIN Ramiz Sadiku” 01 tetor 1983 deri më 21 shkurt 2006 (momenti edhe kur është privatizuar NSH-ja).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante librezën e punës si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës prej 1,350.00 €, në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, gjykata është bazuar në nenin 76.7.4 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 si dhe dëshmitë e ofruara për stazhin e tij të punës dhe pagën të cilën e ka llogaritur vetë ankuesi në kërkesën e tij në procedurë të likuidimit tek AL si dhe me rastin e parashtrimit të ankesës së tij në gjykatë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se ankuesit nuk i takon kompensimi në këtë rast pasi nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH në apo se nuk ka punuar në NSH para privatizimit dhe nuk ka marrë ndonjë kompensim nga NSH-ja, nuk është i drejtë. Gjykata vlerëson se e paditura nuk ka mundur të dëshmojë faktin se ankuesi nuk e ka pasur statusin e punëtorit të NSH dhe faktin se me cilën bazë ligjore e ka bërë ndarjen e punëtorëve aktiv dhe pasiv, pasi që asnjë dispozitë ligjore e zbatueshme në Republikën e Kosovës nuk e parasheh këtë ndarje. Ligji i Punës i cili është në fuqi nga viti 2010, parasheh, mënyrën e themelimit të marrëdhënies së punës, përfundimin e një marrëdhënie të punës dhe të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve që janë në marrëdhënie pune të një punëdhënës i caktuar. Nga provat e lartcekura, përkatësisht nga librezat e punës shihet që ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune me NSH deri në kohën e privatizimit të saj, ndërsa e paditura nuk ka dëshmuar se me ndonjë akt të ligjshëm ia kishte ndërprerë ankuesit marrëdhënien e punës para kohës së privatizimit.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kështu i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-21-0041, AC-I-21-0039, etj.).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar